

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË

Fakulteti Ekonomik

Departamenti: Biznes & Menaxhment

(Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



PUNIM DIPLOME

Studente:

Plotmirë HAZIRAJ

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË

Fakulteti Ekonomik

Departamenti: Biznes & Menaxhment

(Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



Lënda: Financat Publike

Tema: Analizimi i mbledhjes së tatimeve dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike – Rasti i Kosovës

Studente:

Plotmirë HAZIRAJ

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI

UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICË

FACULTY OF ECONOMICS

**DEPARTMENT: BUSINESS & MANAGEMENT (SPECIALIZATION: BANK,
FINANCES AND ACCOUNTING)**



BACHELOR THESIS

**ANALYSIS OF TAX COLLECTION AND THEIR IMPACT ON ECONOMIC
GROWTH – THE CASE OF KOSOVO**

The candidate:

Plotmirë HAZIRAJ

Mentor:

Prof. Asoc.Dr. Esat DURGUTI

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË

FAKULTETI EKONOMIK

**DEPARTAMENTI: BIZNES & MENAXHMENT (SPECIALIZIM: BANKA,
FINANCA DHE KONTABILITET)**



PUNIM DIPLOME

Lënda: Financat Publike

Titulli i punimit: “Analizimi i mbledhjes se tatimeve dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike – Rasti i Kosovës”

Emri dhe mbiemri: Plotmirë HAZIRAJ

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 2005031039

Niveli i studimeve: Baçelor

Departamenti: Biznes & Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

Programi i studimeve: Biznes & Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

Mentori i punimit: Prof.asoc.dr. Esat DURGUTI

Aprovuar prej komisionit:

- _____ Mentor
/Emri Mbiemri, Titulli /
- _____ Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /
- _____ Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

FALËNDERIME

Falënderimin dhe përlujen më të madhe për këtë arritje akademike, të shoqëruar me shëndetin, fatin, lumturinë, dashurinë dhe të gjitha sukseset që gëzojë deri tani i falem ZOTIT!

Përjetë falënderuese u jam prindërve të mi: *IMERIT dhe VLORËS*, që përveç se janë vatër e jetës dhe dashurisë për mua, ishin shtylla më e madhe e mbështetjes dhe forcës përgjatë gjithë këtyre viteve të shkollimit tim, e poashtu psikologët, orientuesit dhe mentorët më të mirë të jetës. Njëkohësisht u jam falënderuese për besimin e plotë në mua, çdo këshillë të dhënë, që të mos dorëzohem, e të menaxhoj stresin dhe lotët para shumë sfidave gjatë studimeve të mia, të cilave iu bëmë ballë së bashku.

Falënderoj vëllain tim, *Artmirin* të cilin e kam shok të jetës dhe ditari në formën e njeriut, i cili asnjëherë nuk u lodh nga kërkesat e mia, duke qenë afër meje këto vite më shumë së asnjëherë më parë.

Në formësimin tim si person, rol të madh ka pasur gjithmonë edhe tezja ime, *Ajmanja* të cilës përveç se i detyrohem që ka qenë udhëzuese e rrugëtimit tim akademik, i jam mirënjohëse që më dha emrin *Plotmirë*, duke nxitur vazhdimisht shpirtin luftarak tek unë, që ta mbrojë domethënien e emrit tim duke e përshtatur e ndërlidhur me personalitetin tim.

Mirënjohëse gjithë jetën Stafit Akademik, shokëve, e kolegëve më të mirë, për krijimin e një jete studentore të mbushur me plot kujtime të mrekullueshme që do jetojnë gjatë në mua.

Në fund falënderoj mentorin tim të temës së diplomës, Prof. Asoc. Dr: Esat DURGUTI , njohësi më i mirë i aftësive dhe potencialit tim i cili vlerësoi dhe mbështeti maksimalisht rrugëtimin tim akademik, përfshirë edhe punimin e temës së diplomës.

Këtë sukses ia dedikoj të gjithë të lartpërmendurve, gjithë familjes dhe veçanërisht gjyshërve të mi :

Halit [Rushit] BARANI (*Heroi i pavdekshëm*) dhe

Bislim [Dibran] HAZIRAJ (*Enciklopedia e gjallë*)!

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Ky punim diplome është punim origjinal dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Dhe nuk përmbanë, sipas njohurisë sonë, asnjë material të botuar ose shkruar nga një person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

STATEMENT OF ORIGINALITY

This thesis is our original work and has not been submitted, in whole or in part, for a degree at this or any other university. Nor does it contain, to the best of our knowledge and belief, any material published or written by another person, except as acknowledged in the text.

Emri/Name

Nënshkrimi/Signature

Data/Date

Përmbajtja

ABSTRAKT	9
ABSTRACT.....	10
HYRJE	11
Paraqitja e problemit	12
Formulimi dhe konteksti i punimit	13
1. HISTORIKU I SISTEMIT FISKAL NË KOSOVË	14
1.1 Tatimi mbi vlerën e shtuar	15
1.2 Tatimi në të ardhurat e korporatave	17
1.3 Tatimi në të ardhurat personale.....	18
1.4 Tatimi në të ardhurat e qirasë.....	21
2. METODOLOGJIA E ANALIZËS	23
2.1 Mbledhja e të dhënave	23
2.2. Përpunimi i të dhënave.....	24
2.3. Statistikat përshkruese	26
2.4. Analiza e korrelacionit.....	27
2.5. Modeli ekonometrik	28
3. DISKUTIMET E TË GJETURAVE	29
4. KONKLuzionet dhe rekomandimet	31
Referenca	33

Lista e tabelave

Tabela 1. Normat tatimore të TAP.....	20
Tabela 2. Përlllogaritja e tatimit të BI.....	21
Tabela 3. Statistikat përshkruese.....	26
Tabela 4. Analiza e korrelacionit	27
Tabela 5. Analiza e regresionit	28

Lista e figurave

Figura 1. Të hyrat e ATK-së ndër vite	15
Figura 2. Trendi i TVSH, TAK, TP, ËR ndër vite	
Burimi: ATK.....	24

Lista e shkurtesave

TVSh – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

TAK – Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

TP – Tatimi në të Ardhurat Personale

WR – Tatimi në të Ardhurat e Qirasë

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

UNMIK – United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

AQF – Autoriteti Qëndror Fiskal

OECD – The Organization for Economic Cooperation and Development

USAID – United States Agency for International Development

BE – Bashkimi Evropian

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

BB – Banka Botërore

GIZ – Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

ABSTRAKT

Punimi analiza e mbledhjes së tatimeve dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike në Kosovë, përfshinë një shqyrtim të gjerë të literaturës lidhur me variablat kyçe: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimi në të Ardhurat e Qirasë (WR). Për të arritur këtë synim, fillimisht është bërë shqyrtimi i literaturës teorike dhe empirike, nga autorë botëror dhe vendor e poashtu është kryer një përpunim i të dhënave të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Banka Botërore. Këto të dhëna janë analizuar me ndihmën e metodave analitike të përfshira në punë, si: analiza përshkruese, analiza e korrelacionit dhe analiza e regresionit. Rezultatet e këtij studimi tregojnë se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale dhe Tatimi në të ardhurat e Qirasë, kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës.

Ky konstatim ka rëndësi thelbësore në rritjen ekonomike, do të thotë që këto lloje tatimesh kanë kontribuar në stimulimin e investimeve dhe aktivitetit ekonomik, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e bizneseve dhe ndërmarrjeve.

Ky studim e pasuron literaturën e mëparshme me të dhëna konkrete nga rasti i Kosovës dhe ofron një perspektivë të hollësishme mbi ndikimin e mbledhjes së tatimeve në aspektin ekonomik. Këto rezultate mund të përdoren për të bërë rekomandime për politikën tatimore në të ardhmen, me synimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike të vendit.

Fjalët kyçe: Rritja ekonomike, TVSH, TAK, TAP, WR, ATK.

ABSTRACT

The paper Analysis of the collection of taxes and their impact on economic growth in Kosovo, included a review of the literature related to the key variables: Value Added Tax (VAT), Corporate Income Tax (CIT), Tax on Personal Income (PIT) and Rental Income Tax (WR). In order to achieve this goal, the theoretical and empirical literature was first reviewed, by world and local authors, and a processing of the data received from the Tax Administration of Kosovo and World Bank was also carried out. These data were analyzed with the help of analytical methods included in the work, such as descriptive analysis, correlation analysis and regression analysis. The results of this study show that taxes, such as Value Added Tax, Corporate Income Tax, Personal Income Tax and Rental Income Tax have a positive impact on Kosovo's economic growth.

This finding has essential importance in economic growth, it means that these types of taxes have contributed to the stimulation of investments and economic activity, creating a more favorable environment for the development of businesses and enterprises.

This study enriches the previous literature with concrete data from the case of Kosovo and offers a detailed perspective on the impact of tax collection in the economic aspect. These results can be used to make recommendations for tax policies in the future, with the aim of sustainable economic growth of the country.

Key words: Economic growth, VAT, CIT, PIT, WR, TAK.

HYRJE

Menjëherë pas përfundimit të luftës së 1999 – së në Kosovë dhe marrja e mandatit nga OKB-ja është parë e domosdoshme që të bëhet themelimi i një agjencie për menaxhimin e sistemit tatimor në Kosovë. Këtë nevojë e plotësoi UNMIK-u, me themelimin e Autoritetit Qëndror Fiskal - AQF. Nga viti 2001, u shtua mbledhja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh). Sistemi u zgjerua më tej me Tatimin në Paga dhe Tatimin në Fitim autoritet ky i cili shërbeu deri në vitin 2003. Nga ky vit e tutje, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) mori drejtimin, ndërsa UNMIK transferoi kompetencat e saj në vitin 2003. ATK është agjensi ekzekutive e pavarur që menaxhon tatimet në Kosovë në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë.

Fillimisht, ATK mbledhte tatimin në shitje, hoteleri dhe më vonë edhe tatimin e paragjykuar. Në vitin 2005, u bë një reformë e madhe e sistemit duke bashkangjitur Tatimin e paragjykuar, Tatimin në Paga dhe Tatimin në të Ardhurat Personale, ndërsa Tatimi në Fitim u zëvendësua me Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Sot, ATK është përgjegjëse për mbledhjen e shumë tatimeve, përfshirë TVSh, Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Tatimin në Paga, Tatimin në Qira, Tatimin në Interes, Tatimin për kategori të veçanta, Tatimin në të drejta pronësore, Tatimin për personat jo-rezidentë, si dhe kontributet pensionale.

Në këtë kontekst, një analizë e hollësishme e sistemit tatimor të Kosovës është e domosdoshme për të vlerësuar efikasitetin e mekanizmave të mbledhjes së tatimeve, zbatimin e tyre praktik, dhe ndikimin e tyre në ndarjen e të ardhurave dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Duke hetuar strukturën e tatimeve, nivelet e evazionit fiskal, dhe efektet e ndryshimeve tatimore në sjelljen e subjekteve ekonomike, mund të arrihet një kuptim më i thellë i mënyrës se si tatimet lidhen me rritjen ekonomike. Një analizë e tillë ka potencialin për t'i ofruar rekomandime konkrete qeverisë dhe palëve të interesit të politikave ekonomike në Kosovë. Përmes përmirësimeve në strukturën e tatimeve, rritjes së transparencës në mbledhjen dhe alokimin e të ardhurave tatimore, si dhe ndërtimit të një mjedisi të favorshëm për biznesin, Kosova mund të hapë rrugën për përparim të ndjeshëm në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kjo analizë synon të kontribuojë në diskursin akademik dhe politik në Kosovë, duke ndihmuar në formulimin e politikave ekonomike të ardhshme dhe duke ofruar një kuptim më të thellë të ndërveprimit kompleks midis mbledhjes së tatimeve dhe performancës ekonomike brenda vendit.

Paraqitja e problemit

Marrë në konsideratë që Kosova grumbullimin e të gjitha të hyrave buxhetore i realizon nga dy burime: **a) dogana** dhe **b) tatimet** e aplikuara, sipas legjislacionit aktual, nëpërmjet këtij punimi synojmë të analizojmë vështirësitë dhe specifikat e mbledhjes së tatimeve si dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike. Prandaj, bazuar në këtë kontekst e parashtrojmë pyetjen kërkimore, e cila njëkohësisht përbën thelbin e punimit.

Pyetja kërkimore: *Si ndikon efikasiteti i mbledhjes së tatimeve në rritjen ekonomike të Kosovës?*

Hipotezat që kemi paraqitur më poshtë bazuar në studimet e mëparshme të kryera në këtë fushë, përbëjnë themelet e këtij punimi të diplomës. Prandaj, hipotezat specifike të punimit janë si në vijim:

- *H₁: Tatimi mbi vlerën e shtuar ka ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të Kosovës.*
- *H₂: Tatimi në të ardhurat e korporatave ka ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të Kosovës.*
- *H₃: Tatimi në të ardhurat personale ka ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të Kosovës.*
- *H₄: Tatimi në të ardhurat e qirasë ka ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të Kosovës.*

Formulimi dhe konteksti i punimit

Në bazë të metodologjisë së punimit, në fillim bëmë një përshkrim të detajuar të variablave kyçe, Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh), Tatimi mbi të ardhurat e korporatave (TAK), Tatimin mbi të ardhurat personale (TAP) dhe Tatimin në ardhurat e qirasë (WR). Pas shqyrtimit të tyre, kemi bërë analiza të avancuara të statistikave përshkruese për zbulimin e tendencave, shpërndarjet dhe variacionet e variablave gjatë periudhës së studiuar. Përveç këtyre analizave, kemi përdorur edhe analizën e korrelacionit për të zbuluar ndërlidhjen e variablave të paraqitura dhe ndërveprimet e ndërsjella mes tyre.

Fazë tjetër me rëndësi e punimit, është përdorimi i testeve diagnostikuese dhe modeli i regresionit (*Poisson regression*) që janë përdorur për vlerësimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimit në të Ardhurat e Qirasë (WR), në rritjen ekonomike të vendit tonë. Duke shpresuar se në fund, rezultatet e nxjerrura, bashkë me rekomandimet tona të përdoren në të ardhmen për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës përmes mbledhjes së tatimeve.

1. HISTORIKU I SISTEMIT FISKAL NË KOSOVË

Zanafilla e tatimeve në Kosovë, daton që nga pas lufta bashkë me ardhjen e misionit të OKB-së në vitin 1999, ku u vendos një administratë ndërkombëtare (UNMIK) për të ndihmuar në ngritjen e administratës dhe strukturave tjera relevante në Kosovë. Në këtë periudhë filloi të formohej sistemi tatimor i ri. Më datën 17 Janar 2000, u themelua Autoriteti Qendror i Tatimeve (AQF) nga UNMIK, i cili ishte përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave tatimore në Kosovë. AQF do vepronte deri në themelimin e Administratës Tatimore të Kosovës. Më 18 Shkurt 2003, u bartën kompetencat e udhëheqjes te Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe që nga atëherë, ATK funksionon si një Agjensi ekzekutive me autonomi të plotë operationale e menaxhuar nga vendorët me asistencë të organizatave donatore ndërkombëtare, përfshirë USAID, BE, FMN, BB, GIZ, Ambasada Britanike, etj.

Në fillimet e saj, Administrata Tatimore e Kosovës ishte e autorizuar të bëjë mbledhjen e tatimit në shitje, tatimit në hoteleri, pastaj nga 1 Korriku i vitit 2000 edhe tatimin e paragjykuar. Të hyrat tatimore të grumbulluara nga AQF në vitin e parë pra 2000, ishin në vlerë simbolike prej 5 milion €.

Nga 1 Korriku i vitit 2001, AQF filloi të ngarkohet me autorizime shtesë për mbledhjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh). Nga viti 2002 sistemi tatimor u zgjerua me disa lloje të tjera të tatimeve, si Tatimi në Paga dhe Tatimi në Fitim. Më pas, nga data 1 Prill 2002 hyri në fuqi Rregullorja e Tatimit në Fitim ku sistemi tatimor avancohet nga tatimi i paragjykuar në tatimin real. Pas tri viteve, në vitin 2005 u aplikua një reformë e sistemit tatimor në Kosovë, ashtu që Tatimi i Paragjykuar dhe Tatimi në Paga u bashkangjitën në Tatimin në të Ardhurat Personale, si dhe u bë zëvendësimi i Tatimit në Fitim me Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. ATK, përveç sukseseve, gjatë viteve u përball dhe ballafaqohet akoma me sfida të ndryshme siç janë:

- Fuqizimi i aftësive/shkathtësive të stafit të ATK-së;
- Përmirësimi i proceseve kyçe tatimore të regjistrimit, deklarimit, kontrollit dhe mbledhjes së detyrueshme;
- Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë jo-formale;
- Zhvillimi i platformës kryesore të Teknologjisë Informative të ATK-së, etj

ATK-ja, aktualisht është përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve si: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh); Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP); Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK); Tatimet e mbajtura në burim; Tatimi në Paga; Tatimi në Qira (WR); Tatimi në interes; Tatimi për kategori të veçanta; Tatimi në të drejta pronësore; Tatimi për personat jo-rezident; Kontributet Pensionale.




Figura 1. Të hyrat e ATK-së ndër vite

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Përgjatë 23 viteve, duke i hequr të gjitha sfidat nëpër të cilat ka kaluar ATK, ka arritur të realizoj projeksionet e të hyrave, të siguroj stabilitet financiar dhe efikasitet duke mbledhur të hyra në vlerë prej: 7 miliard e 012 milion euro – Tatime dhe 2 miliard e 607 euro – Kontribute Pensionale.

1.1 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) është një tatim shpenzimesh i cili e përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në shpenzime për mallra dhe shërbime, i cili është në proporcion me çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave e shërbimeve që bartet nga konsumatori i fundit (LIGJIT NR. 05/L-037 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR 2015).

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) zbatohet në secilën fazë të prodhimit dhe shpërndarjes së një produkti, nga fazat e para deri te shitja përfundimtare. Kjo taksë shtohet në çdo fazë të procesit për të përshpejtuar rritjen e vlerës së produktit. Shuma e tatimit përcaktohet në fazën e fundit të prodhimit, duke llogaritur totalin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së) nga të gjitha fazat e mëparshme dhe zbritjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së) paguar për blerjet. Duke e parandaluar kështu taksimin e dyfishtë dhe duke siguruar që blerësit në secilën fazë të rimbursohen për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – në) që e kanë paguar me para (Metcalf, 1995). Secili biznes gjatë rrjedhës së prodhimit e deri tek dërgimi i mallit te shitësi me pakicë, në shitjet e tij ngarkon Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – në) si dhe në dërgimin e pagesave të tatim autoritetit, e që iu lejon të bëjë zbritjen nga shumat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së) për atë që është paguar gjatë blerjes (Mikesell, 2011). Në Kosovë, Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh), aplikohet që nga viti 2001 bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001\11, e që nga atëherë deri tani ka pasur ndryshime ndër vite. Si bazë e TVSH-së njihet ndryshimi mes çmimit furnizues dhe atij të shitjes.

TVSH-ja në Kosovë aplikohet në tri norma:

- Norma standarde prej 18%, ku përfshihen të gjitha produktet dhe shërbimet përveç mallrave dhe shërbimeve që bëjnë pjesë në normën e reduktuar: citostatikët, norma për eksport, inpute bujqësore dhe transport ndërkombëtar, ku TVSH është 0% e vlerës së tatueshme;
- Norma e reduktuar prej 8% për furnizimin me mallra dhe shërbime si dhe importin e tyre si:
 - Furnizimi me ujë;
 - Furnizimi me energji elektrike;
 - Drithërat (gruri, elbi, misri, thekra, orizi, etj.);
 - Prodhimet nga drithërat;
 - Vajërat për gatim;
 - Qumështi dhe produktet e qumështit;
 - Kripa, vezët;
 - Librat shkollorë;
 - Pajisjet e teknologjisë informative;
 - Furnizimi me barna;
 - Pajisjet mjekësore.

Përmes Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së) mbliidhen të hyrat më të mëdha tatimore që arkëtohen në buxhet nga shteti. Ajo çka e mundëson në mënyrë të sigurtë, mbledhjen efikase të të hyrave buxhetore, është faza e shitjes apo tregtisë me pakicë. Në vendin tonë, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar i aplikohet bizneseve me më shumë se 30.000€ qarkullim vjetor, të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe duhet që patjetër të regjistrohet në Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh), ku nëse ka arritur një limit të përcaktuar, fiton titullin si person i tatueshëm dhe kërkohet që të mbajë libra dhe regjistrime në pajtim me Rregulloren e cila është në fuqi (ATK, 2015).

Konsumatori e paguan Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – në) atëherë kur blen mallin apo shërbimin nga subjektet e regjistruara si deklarues të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së). Obligimi për pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh – së) lind në këto raste:

- Në momentin kur merret pagesa,
- Kur bëhet lëshimi i faturës dhe
- Kur kryhet shërbimi ndaj klientit apo bëhet dorëzimi i mallit te klienti.

1.2 Tatimi në të ardhurat e korporatave

Për të siguruar të njëjtin nivel të të ardhurave tatimore si në sistemin klasik të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK), është e nevojshme që norma e tatimit mbi fitimet e jashtëzakonshme (fitimet që shkelin nivelin normal të fitimit për një biznes të caktuar) të jetë më e lartë. Në një ekonomi të mbyllur kjo nuk do duhej të dëmtonte investimet, pasi fitimet normale janë të pa tatimuara¹. Megjithatë, në një ekonomi të hapur, në të cilën kompanitë ndërkombëtare vendosin se ku të ndërmarrin projektet e tyre fitimprurëse të investimeve direkte, qiraja ekonomike pas tatimit mund të jetë gjithnjë e më e rëndësishme (Devereux dhe Griffith, 1998). Arsyeja kryesore se pse ekziston Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) është vështirësia për të administruar një tatim mbi të gjitha të ardhurat kapitale që i grumbullohen çdo individ, duke përfshirë çdo fitim të mbajtur në një kompani e cila është pjesërisht në pronësi të atij personi (Mintz, 1996).

¹ Fitimet normale janë shuma e parave që një individ apo një kompani realizojnë nga aktivitetet e tyre biznesore ose të tjera burime të ndryshme, si investimet, shitjet, interesat, etj. Këto fitime janë të pa-tatimuara pasi ka ligje dhe rregullore që i lejojnë individëve dhe kompanive të paguajnë një pjesë të caktuar të fitimeve në formë taksash ndaj qeverisë, pasi të kenë tërhequr shpenzimet e nevojshme për operacionet dhe investimet e tyre.

Në mënyrë të veçantë, fitimet kapitale nga aksionet e krijuara nga mbajtja e korporatave janë të vështira për tatimin në bazë të akrualeve. Kështu, meqenëse është e mundur të vendoset një tatim në nivel korporate në të ardhurat e mbajtura të korporatës, një tatim i tillë mund të veprojë si një zëvendësues i arsyeshëm për tatimet personale edhe nëse normat tatimore nuk janë identike (Bird, 1996).

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) apo tatimi në fitim është tatim që i aplikohet ndërmarrjeve ekonomike mbi fitimin e tyre. Sipas ligjit, tatimpagues janë këta persona:

1. Korporata ose ndërmarrje tjetër afariste me statusin e personit juridik;
2. Shoqëria tregtare e cila vepron me pasuri në pronësi publike;
3. Organizatat joqeveritare dhe
4. Personat jo rezident në Kosovë.

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) aplikohet në të ardhurat e tatueshme të korporatave. Tatimpaguesit të cilët kanë të ardhura bruto vjetore me vlerë prej 30.000€ ose më pak taten me normën 3% (por jo më pak se 37.5€ për 3 mujorin) që aplikohet për tregti, transport, bujqësi dhe veprimtari të ngjashme komerciale apo 9% (për veprimtari shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme por jo më pak se 37.5€ për 3 mujorin). Dhe 10% e të ardhurave neto të qirasë për 3 mujorë e cila zvogëlohet nga çdo shumë e tatimit të mbajtur në burim gjatë atij 3 mujori (LIGJI Nr. 05/L -029 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE).

1.3 Tatimi në të ardhurat personale

Një nga faktorët e përmendur më shpesh të çdo sistemi të tatimit mbi të ardhurat, është norma e Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP). Kjo është një normë tatimore marxhinale e përcaktuar ligjërisht e zbatueshme për grupet kryesore në tatimin mbi të ardhurat. Kjo normë e veçantë tatimore është përdorur herë pas here në kërkime empirike ndërvendore si një variabël përafruese për progresivitetin tatimor ose si një mënyrë për vlerësimin e barrës së përgjithshme tatimore të tepërt (Johnson, Kaufmann dhe Zoido-Lobaton 1998).

Rreth njëqind vjet më parë, Seligman (1908) vërejti se “prirja drejt tatimit progresiv është pothuajse kudo në rritje”. Pika më e lartë e TAP-it e njohur në histori ishte në Holandë me normë 37.5%, deri në vitin 1981, ku kjo shkallë ndryshoi pasi 4 nga çdo 5 vende kishte normën më të lartë të Tatimit në të

Ardhurat Personale (TAP) që kalonte 37.5%, me maksimumin 90% në Iran (Peter et al, 2008). Mesatarja e normave më të larta marxhinale të Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP)-it ishte 62% midis 108 vendeve. Sistemet për Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) shpesh rëndoheshin nga skema të shumta tatimore, formula të komplikuar tatimore, shtesat, përjashtimet e shumta dhe shkallët e përshkallëzuara të taksave shumë të ndara. Megjithatë, shumë qeveri bënë ndryshime të rëndësishme në sistemet e tyre kombëtare të Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP), që nga viti 1981. Norma mesatare e Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP) ra nga 62% në 1981 në 42.9% në vitin 1991 dhe deri në vitin 2005 arritën nivelin më të ulët të njëzet e pesë viteve prej 36.4% (Paulus dhe Peichl, 2008).

Në Kosovë, Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) është aplikuar që nga 1 prilli i vitit 2002 dhe deri në fund të vitit 2004 që është aplikuar vetëm në paga ndërsa tani aplikohet në të gjitha të ardhurat e tatueshme në bazë të Ligjit për Tatim në të Ardhura Personale e që i pranon një individ.

Tatimpagues të të ardhurave personale mund të jenë: Personat fizik të cilët janë rezident në Kosovë dhe ata që nuk janë rezident, bizneset individuale (personale), shoqëritë apo ortakëritë e përgjithshme, dhe shoqëritë apo ortakëritë të kufizuara dhe ndërmarrjet personale (LIGJI NR.05\L-028).

Në Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) përfshihen edhe paga, qiraja, pensionet, dividendat, fitimet/humbjet kapitale dhe çdo e ardhur nga e cila rritet vlera neto e një tatimpaguesi, i cili i referohet periudhave tatimore prej një viti kalendarik (Komoni, 2008). Të ardhura të tatueshme për një periudhë tatimore konsiderohet ndryshimi bruto i të ardhurave apo gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve të lejueshme në lidhje me ato të ardhura bruto. Dallohen dy sisteme kryesore për tatimin mbi të ardhurat:

- Sistemi tatimor global dhe
- Sistemi tatimor tabelar mbi të ardhura.

Rritja e tatimit rritet duke u rritur të ardhurat ose me shkallë fikse të para caktuara. Për të ardhurat e tatueshme, tatimi në të ardhura personale zbatohet sipas këtyre kritereve si në vijim:

Tabela 1. Normat tatimore të TAP

Norma tatimore për tatim në Të Ardhura Personale (TAP)		
<i>Norma tatimore</i>	<i>Të ardhurat mujore</i>	<i>Te ardhurat vjetore në €</i>
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 e tutje	5400 e tutje

Burimi: Ligji TAP

Shembull 1. Përlllogaritja e pagës

Për të parë se si bëhet përlllogaritja e tatimit të një pagë, kemi marrë shembull një X të punësuar në Kosovë, me pagën mujore prej 600.00€ bruto.

$$600.00\text{€ Paga Bruto} - 5\% \text{ Kontribute Pensionale} = 570.00\text{€}$$

$$600.00\text{€} \times 0.005 = 30\text{€}$$

Bazuar në tabelën më lartë kemi:

$$0 \text{ deri } 80 = 0.00\text{€}$$

$$250\text{€} - 80\text{€} = 170\text{€} \times 4\% = 6.80\text{€}$$

$$450\text{€} - 250\text{€} = 200\text{€} \times 8\% = 16.00\text{€}$$

$$570\text{€} - 450\text{€} = 120\text{€} \times 10\% = 12.00\text{€}$$

$$\text{Tatimi në pagë} = 34.80\text{€}$$

$$\text{Paga Bruto} = 600.00\text{€}$$

$$-\text{Tatimi në pagë} = 34.80\text{€}$$

$$-\text{Kontributet Pensionale} = 30.00\text{€}$$

$$\text{Paga Neto} = 535.20\text{€}$$

Shembull 2. Përlllogaritja e tatimit të Biznesit Individual

Për ta parë se si bëhet llogaritja e tatimeve në Biznese Individuale, kemi marrë si shembull një Biznes Individual – Tregtar me qarkullim vjetor 25,000.00€, gjatë vitit 2022.

Tabela 2. Përlllogaritja e tatimit të BI

Përlllogaritja e tatimit të Biznesit Individual				Fondi Pensional (1/3 e tatimeve)
Tremujori	Qarkullimi	Përqindja	Tatimi	
TM1	4,000.00 €	3%	120.00 €	40.00 €
TM2	5,000.00 €	3%	150.00 €	50.00 €
TM3	6,000.00 €	3%	180.00 €	60.00 €
TM4	10,000.00 €	3%	300.00 €	100.00 €
Totali	25,000.00 €		750.00 €	250.00 €

Burimi: Kalkulimet e autorit

1.4 Tatimi në të ardhurat e qirasë

Pajtueshmëria tatimore është parë tradicionalisht si e panevojshme nga shumë tatimpagues. Megjithatë sot, rreziqet e anashkalimit të detyrimeve tatimore dhe përfitimet e mundshme të një përpjekjeje aktive për pajtueshmërinë tatimore nuk kanë qenë kurrë më të larta. Shumë huadhënës as nuk do të konsiderojnë sigurimin e financimit për një kompani, që nuk mund të demonstrojë pajtueshmëri me tatimet e aplikueshme të shitjeve, pronës personale dhe të ardhurave (Serem et al 2017).

Por, disa mund të jenë të gatshëm të ofrojnë një linjë më të madhe krediti ose të ulin normat e interesit për kompanitë, që mund të provojnë pajtueshmërinë. Edhe pse shpërblimet për pajtueshmërinë tatimore mund të jenë të mëdha, poashtu mund të jenë edhe rreziqet dhe kostot e mospërputhjes. Blerësit e mundshëm shqyrtojnë me kujdes të dhënat e pagesave të taksave dhe zbresin në mënyrë të konsiderueshme ose madje shmangin plotësisht qiranë, portofolet ose kompanitë me praktika të dyshimta përputhshmërie.

Pavarësisht nga niveli i ndërgjegjësimit të tatimpaguesëve për tatimin, të ardhurat tatimore nga shumica e sektorëve nuk kanë qenë proporcionale. Gjatë vitit financiar 2011/2012 arkëtimi vjetor sipas raportit të Kenya Revenue Authority ishte 707.4 miliardë \$ kundrejt një objekti prej 717 miliardë \$. (Kenya Revenue Authority, 2012). Sipas një raportit “Kenya Annual Performance” në Kenia, raportohet se mbledhja e qirave ra nga 5 miliardë në 2007 në 1 miliardë në vitin 2009.

Raporti deklaroi se një koleksion i mëtejshëm prej 1.5 miliardë \$ u rikuperua nga pronarët dhe ndërtuesit e pronave që nuk ishin në përputhje. Ky është një tregues se kur niveli i përputhshmërisë është i ulët, mbledhja e të ardhurave të qeverisë gjithmonë bie prapa objektivave (<https://www.kra.go.ke/>).

Në Kosovë, Tatimi në të Ardhurat e Qirasë (WR) dhe pasuria e paprekshme është formë e tatimit në të ardhurat personale, i cili bazohet në dhënien e pasurisë në shfrytëzim me qira. Në të ardhurat bruto nga qiraja bëjnë pjesë:

- a. Të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurisë të paluejtëshme siç janë: ndërtesat, toka, apartamentet, lokalet etj.
- b. Të ardhurat e fituara nga dhënia me qira e pajisjeve, automjeteve dhe llojeve tjera të pasurisë.

Çdo tatimpagues që realizon të ardhura nga marrja e qirasë duhet të paguaj në baza mujore, apo çdo tremujor tatimin në një bankë apo institucion bankar (Komoni, 2011). Personat fizik, të cilët realizojnë të ardhura nga qiraja konsiderohen tatimpagues. Tatimpaguesi është i obliguar të paguaj tatim prej qirasë çdo tre muaj në përqindje prej 10%. Pasi që të zbriten shpenzimet e mirëmbajtjes së objektit. Tatimi në qira deklarohet për çdo tremujor dhe pagesa bëhet brenda 15 ditëve të muajit vijues pas përfundimit të tremujorit. (LIGJI NR.05/L-028).

KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E ANALIZËS EKONOMETRIKE

2. METODOLOGJIA E ANALIZËS

Kjo temë diplome bazohet në mbledhjen e të dhënave tatimore dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike duke përfshirë 5 observime nga viti 2018-2022 në Kosovë. Në këtë punim variabla me prioritet është Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së), por gjithashtu përfshihen edhe variablat e tjera si: Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimi në të Ardhurat e Qirasë (WR). Për të vlerësuar ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike në Kosovë, tutje janë bërë edhe analiza të tjera statistikore. Përcaktimi i variablës së varur është rritja ekonomike, ndërsa variablat e pavarura janë tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat nga korporata, tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në qira.

Metodologjia e përdorur në këtë punim diplome është metoda sasiore e bazuar në të dhënat sekondare të nxjerrura nga (<https://www.atk-ks.org/>), ndërsa për rritjen ekonomike janë shfrytëzuar të dhënat nga Banka Botërore (<https://data.worldbank.org/indicator>). Si metoda analizuese dhe krahasuese janë përdorë studimet e realizuara më herët në këtë disiplinë me qëllim të vëzhgimit nëse janë gjetur lidhje pozitive apo negative mes variablave të lartëcekura, ndërsa metoda sasiore përfshin grumbullimin e të dhënave statistikore në faqen e internetit të Administratës Tatimore të Kosovës lidhje me Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), Tatimin në të ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimin në të ardhurat personale (TAP) dhe Tatimin në të ardhurat e qirasë (WR). Gjithë burimet e përdorura janë burime të besueshme dhe serioze.

2.1 Mbledhja e të dhënave


Të dhënat e përdorura në këtë temë diplome janë të dhëna dytësore, të shprehura në baza vjetore me gjithsej 5 vëzhgime. Këto të dhënat janë siguruar nga data baza e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), ([Indicators | Data \(worldbank.org\)](https://data.worldbank.org/)). Këto të dhëna janë të besueshme, pasi që janë të mbledhura nga një agjension kredibil qeveritar për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontrollin e zbatimit të ligjit tatimor në Kosovë. Arsyeja e mospërfshirjes së periudhave të më hershme qëndron në atë se disa nga variablat nuk posedonin të dhënat adekuate. Variablat e përfshira janë:

- Rritja ekonomike,
- TVSH,
- Të ardhurat e korporatës,
- Të ardhurat personale,
- Të ardhurat e qirasë.

2.2. Përpunimi i të dhënave

Pasi që të dhënat janë marrë nga databaza e Administratës Tatimore të Kosovës dhe Bankës Botërore, ato janë strukturuar dhe adaptuar formës së përpunimit, për t'i arritur objektivat e parashtruara në pyetjen kërkimore, si dhe verifikimit të tyre sipas hipotezave të parashtruara. Për të përpunuar këto të dhëna është shfrytëzuar programi STATA, prej nga janë nxjerrë analizat si në vijim:

- Statistikat përshkruese,
- Analiza e korrelacionit,
- Analiza e regresionit.



*Figura 2. Trendi i TVSH, TAK, TP, WR ndër vite
Burimi: ATK*

Në figurën 2, është paraqitur trendi i mbledhjes së tatimeve TVSH, TAK, TP dhe WR nga viti 2017 deri në vitin 2022. Me anë të grafikonit mund të vërehet se në vitin 2017, ka pasur të hyra të TVSH-së, prej 195 milion € duke shënuar rritje nga viti 2018 me 209 milion € deri në vitin 2019 me 234 milion €, e duke pasuar me një rënie në vitin 2020, me të hyra prej 219 milion €. Në vitin 2021 dhe 2022 kemi pasur ngritje të të hyrave të TVSH-së në 285 milion € dhe në vitin pasues 337 milion€.

Nëse të njëjtat rezultate i krahasojmë ndër vite, në formë të përqindjes, vërehet se nga viti 2017 në vitin 2018 kemi pasur rritje të të hyrave të TVSH-së me rreth 6.7%, nëse krahasojmë vitin 2018 me vitin 2019, del se në të hyrat e TVSH-së ka pasur rënie për rreth 11.8%. Raporti mes vitit 2019 dhe 2020 shënon rënie prej rreth 6.8%, tutje kemi një rritje prej 23.1% nga viti 2020 në vitin 2021 dhe së fundmi një rritje e të hyrave të TVSH-së nga viti 2021 në vitin 2022, 15.4%.

Sa i përket TAK-së dallimi nga viti 2017 në vitin 2018 shënon rritje me 13.1% në të hyrat e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave. Në vitin pasues 2018 vërehet rritje e të hyrave me 11.5% në vitin 2019. Për dallim nga ky vit, në periudhën nga viti 2019 në vitin 2020 të hyrat nga TAK kanë pësuar rënie prej 14.5%. Përkundër kësaj rënie, në periudhën 2020-2021 sërish të hyrat kishin rritje prre 25.2% e po ashtu periudha 2021-2022 shënoi rritje prej 30.19%.

Analizojmë sipas grafikut Tatimin në të Ardhurat Personale TAP, ku fillojmë me rritje prej 8.33% nga viti 2017 në vitin 2018. Përkundrazi dallimi mes vitit 2018 dhe 2019 del të jetë 4.35% rënie në të hyrat, duke e vazhduar këtë trend edhe në vitin vijues 2019-2020 me 21.5% rënie. Ky trend rëniesh ndalon me periudhën 2020 – 2021 ku të hyrat e TAP, ndeshen me 24% rritje, e ngjashëm ndodh edhe me 2021 – 2022 ku shihet rritje prej përqindjës 16.67%.

Në fund kemi edhe Tatimin në të Ardhurat e Qirasë ku nga grafiku, fillimisht vërehet vitin 2017 – 2018 me një rënie prej 75%, përkundër këtyre rezultateve, në periudhën 2018 – 2019 në të hyrat nga WR kemi rritje prej 80%. Në periudhën pasuese, nga viti 2019 në vitin 2020 përballemi me një rënie prej 81%. Në dy periudhat e fundit sërish të hyrat nga WR tregojnë rritje ku në periudhën 2020 – 2021 kjo rritje del të jetë me përqindje 20.8%, ndërsa nga viti 2021 në 2022 me 14.29% rritje.

2.3. Statistikat përshkruese

Gjetjet në kuadër të kësaj teme diplome, kanë fokus ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike duke përfshirë rastin e Kosovës me 5 vëzhgime, që është paraqitur në Tabelën 3. Nga të gjeturat mund të shohim se vlera mesatare e rritjes ekonomike është 8,467.36 milion € me një devijim standard 873.06 milion €. Vlera më e lartë e arritur e rritjes ekonomike në vend është 9, 429, 16 milion € dhe vlera më e ulët prej 7, 717, 14 milion €. Tutje, vlera mesatare e tatimit mbi vlerën e shtuar është 257.54 milion € me një devijim standard 53.50 milion €, vlerën më të lartë 337.64 milion € dhe vlerën më të ulët 209.95 milion €. Më pas, vlera mesatare e tatimit në të ardhurat e korporatave është 106.92 milion € me një devijim standard 31.4 milion € si dhe vlera më e madhe 159.43 milion € dhe vlera më e vogël 83.53 milion €.

Në këto gjetje përfshihen edhe tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në të ardhurat nga qiraja. Vlera mesatare e tatimit në të ardhurat personale në këtë vend është 24.618 milion €, devijimi standard 4.10 milion €, vlera më e madhe 30.58 milion € dhe vlera më e vogël e tyre është 19.17 milion €. Në fund vlera mesatare e tatimit në të ardhura nga qiraja është 21.77 milion € me një devijim standard 5.04 milion €, me vlerën më të madhe të tyre 28.64 milion € dhe vlerën më të vogël 15.32 milion €. Variabla me fokus më të madh është rritja ekonomike, e cila paraqet variablën e varur në këtë temë e ku më pas do të studiohet ndikimi i variablave tjera të pavarura në të.

Tabela 3. Statistikat përshkruese

<i>Variable</i>	<i>Obs</i>	<i>Mean</i>	<i>Std. Dev.</i>	<i>Min</i>	<i>Max</i>
<i>Rritja ekonomike</i>	5	8,467.36	873.06	7,717.14	9,429.16
<i>TVSH</i>	5	257.54	53.51	209.95	337.64
<i>CD</i>	5	106.92	31.39	83.53	159.43
<i>PD</i>	5	24.62	4.10	19.17	30.58
<i>WR</i>	5	21.77	5.04	15.32	28.64

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.4. Korrelacionet

Matrica e koeficientëve të korrelacionit për variablat është dhënë në Tabelën 4. Në bazë të të gjeturave në këtë analizë, shohim se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) ka korrelacion pozitiv me rritjen ekonomike. Gjithashtu korrelacion pozitiv ka Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) me rritjen ekonomike dhe me Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-në). Si dhe Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) ka korrelacion pozitiv me rritjen ekonomike, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK). Dhe në fund Tatimi në të Ardhurat e Qirasë (WR), ka një ndërlidhje pozitive me rritjen ekonomike, Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-në), Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK), dhe me Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP).

Tabela 4. Analiza e korrelacionit

	<i>Rritja ekonomike</i>	<i>TVSH</i>	<i>TAK</i>	<i>TAP</i>	<i>WR</i>
<i>Rritja ekonomike</i>	1.0000				
<i>TVSH</i>	0.9274	1.0000			
<i>TAK</i>	0.8362	0.9723	1.0000		
<i>TAP</i>	0.7917	0.8442	0.8938	1.0000	
<i>WR</i>	0.8366	0.8149	0.8083	0.7852	1.0000

Burimi: Kalkulimet e autorit

Për më tepër, kjo analizë përveç që na jep indikacione mbi shkallën e ndërlidhshmërisë së variablave, ajo gjithashtu shfrytëzohet nëse të dhënat e aplikuara në punim kanë shqetësime me shumë llojshmëri të të dhënave, duke u bazuar në vlerën e koeficientëve. Si konkluzion i përgjithshëm, mund të themi se ka ndërlidhje të fortë në mes të rritjes ekonomike dhe llojeve të tatimeve. Por, megjithatë kjo analizë na jep indikacione të qarta rreth asaj se këto tatime kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike, në kontekstin e Kosovës.

2.5. Modeli ekonometrik

Për të hetuar ndikimin e variablave të varura në rritjen ekonomike në kontekstin e Kosovës, dhe specifikat e të dhënave kemi aplikuar qasjen e regresionit poisson. Synimi i aplikimit të kësaj qasje është për të vërtetuar apo refuzuar hipotezat e parashtruara në fillim të punimit. Formula e regresionit poisson është:

$$\text{Rritja ekonomike}_i = \tau_i + \beta_1(\text{TVSH}_i) + \beta_2(\text{TAK}_i) + \beta_3(\text{TAP}_i) + \beta_4(\text{WR}_i) + \varepsilon_i$$

Ku: Rritja ekonomike_i – tregon variablën e varur, τ_i - tregon koeficientin e regresionit, $\beta_1 - \beta_4$ - tregon variablat e varura, i – tregon vitet, dhe ε_i - gabimet e mundshme.

Pas prezantimit dhe sqarimit të qasjes ekonometrike të aplikuar, si dhe diskutimeve paraprake është e domosdoshme që të analizohet dhe diskutohet edhe testi Wald Chi (4) = 359.05 mbi përshtatjen e të dhënave në model. Bazuar në rezultatet e këtij testi shihet se vlera e ρ - value [$\rho = 0.0000$] është signifikante në nivel të besueshmërisë prej 99.99 përqind. Dhe bazuar në këtë mund të konstatojmë se aplikimi i qasjes së përzgjedhur është adekuate. Të gjeturat janë të paraqitura në Tabelën 5, si dhe diskutimi i tyre do të bëhet në kapitullin e ardhshëm në mënyrë të detalizuar.

Tabela 5. Analiza e regresionit

Variables	Coefficient	P>[z]
TVSH	.0041432***	0.000
TAK	.0059551***	0.000
TAP	.0109727***	0.001
WR	.0039576**	0.051
_cons	8.253184	0.000
Wald chi2(4)	359.05	0.0000
Observime	5	5

Burimi: Kalkulimet e autorit

3. DISKUTIMET E TË GJETURAVE

Ky kapitull ashtu si është nënvizuar më lartë, do të përfshijë të gjeturat dhe diskutimet e tyre duke krijuar edhe ndërlidhjen me pyetjen kërkimore si dhe verifikimin apo refuzimin e hipotezave të parashtruara. Prandaj, duke u nisur nga rezultatet e gjeneruara sipas analizës së regresionit, të gjitha variablat e aplikuara kanë ndikim të rëndësishëm statistikor ndaj rritjes ekonomike për periudhën e observuar. Për më tepër, vërejmë se ndikim të rëndësishëm pozitiv kanë Tatimi mbi Vlerën e shtuar, Tatimi në të Ardhurat e Korporatës , Tatimi në të Ardhurat Personale dhe Tatimi mbi Qiranë.

Të gjeturat për tatimin e vlerës së shtuar zbulojnë se ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike, dhe këtë konkludim e bazojmë në vlerën e koeficientit ($\beta = 0.0041432$) me probabilitet $\rho = 0.000$. Ky rezultat na dëshmon se çdo rritje e vëllimit të tatimit të vlerës së shtuar ka ndikim në rritje ekonomike, ose shprehur ndryshe për çdo njësi të rritjes së tatimit të vlerës së shtuar ndikon në rritje prej 0.004 pikë njësi në rritje ekonomike me kusht që variablat tjera të mbesin konstant. Këtu vlen të theksohet se bazuar në të gjeturat, është bërë konfirmimi apo verifikimi i hipotezës (H_1). Konkludimet tona janë në frymën e studimit të realizuar nga autorët Ormaechea dhe Morozumi, (2021) ku kanë analizuar efektin e mbledhjes së tatimit të vlerës së shtuar dhe ndikimin e tij në promovimin e rritjes ekonomike për vendet e OECD-së. Të gjeturat e këtij studimi argumentojnë se ekziston një lidhje pozitive ndërmjet tyre si në aspektin afatshkurtër po edhe në termat afagjatë. Prandaj, autoritetet respektive duhet t'i kushtojnë rëndësi këtij tatimi, pasi që ka implikime pozitive në rritjen ekonomike, poashtu nga aspekti i konsumit e rritë koston e jetës.

Tutje, të gjeturat për tatimin në të ardhurat e korporatave na tregojnë se ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike, në bazë të koeficientit ($\beta = 0.0059551$) me probabilitet $\rho = 0.000$. Në bazë të kësaj dëshmohet se, çdo njësi më shumë në tatimin në të ardhurat e korporatave ndikon në rritjen ekonomike, ose thënë ndryshe çdo njësi më shumë rrit për 0.0059 njësi rritjen ekonomike. Me kusht që variablat tjera të mbesin konstant. Dhe, në bazë të kësaj është bërë konfirmimi i hipotezës (H_2). Konkludimet tona janë në përputhje me studimin e bërë nga (Hungerford, 2013).

Bazuar në gjetjet tona edhe Tatimi në të ardhurat personale ka ndikim të dukshëm në rritjen ekonomike, në bazë të koeficientit ($\beta = .0109727$), probabiliteti i të cilit është $p = (0.001)$, ku rrjedhimisht bënë të kuptojmë se çdo rritje e njësive të tatimit në të ardhurat personale, ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit tonë. Me këto rezultate verifikohet vërtetësia e hipotezës (H_3). Në të njëjtin konkluzion kanë rënë edhe autorët (Abizadeh, 2005), duke u pajtuar se sa më shumë tatime të deklaruar që janë bërë në kuadër të të ardhurave në tatime personale e kanë dërguar ekonominë drejt rritjes, qysh në vitet e mëhershme.

Për më tepër, me një ndikim pozitiv, duket të jetë Tatimi në të ardhurat e Qirasë (ËR). Me anë të gjetjeve tona vërejmë se koeficienti ($\beta = .0039576$) i cili ka probabilitetin $p = (0.051)$, na tregon se rritja e të hyrave të tatimit në të ardhurat e qirasë, ndikon po ashtu pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit tonë. Ky rezultat bënë që të verifikohet edhe Hipoteza jonë e fundit (H_4). Mirëpo me gjetjet tona nuk pajtohet autori (Austin, 2019), ku në studimin e bërë ai tregon se në vendin e tij, Nigerinë tatimi në të ardhurat e qirasë ka impakt negativ në rritjen ekonomike. Mirëpo, kjo çështje varion në bazë të të hyrave të secilit vend, në bazë të politikave fiskale, ekonomike dhe shumë faktorëve të tjerë.

4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Si përfundim, punimi i diplomës përmbanë një analizë të mbledhjes së tatimeve dhe ndikimit të tyre në rritjen ekonomike të Kosovës, ka përfshirë një shqyrtim të thellë të literaturës ekzistuese dhe një analizë të detajuar të të dhënave të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Banka Botërore. Nëpërmjet metodave analitike të përdorura, si analiza përshkruese, analiza e korrelacionit dhe analiza e regresionit, kemi arritur të kuptojmë ndikimin e llojeve të ndryshme të tatimeve në performancën ekonomike të vendit.

Rezultatet e kësaj analize kanë theksuar se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK), Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimi në të Ardhurat e Qirasë (WR), kanë kontribuar në një rritje pozitive të ekonomisë kosovare. Këto lloje tatimesh kanë ndihmuar në tërheqjen e investimeve dhe nxitjen e aktivitetit ekonomik, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve dhe promovuar rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Me anë të këtyre rezultateve, analizave dhe projekteve kemi arritur që të vërtetojmë apo verifikojmë të gjitha hipotezat, që kemi ngritur e njëkohësisht duke iu përgjigjur edhe pyetjes sonë të parashtruar kërkimore.

Ky studim shpresoj të ketë kontribuar në zgjerimin e literaturës së disponueshme mbi ndikimin e tatimeve në ekonominë e Kosovës, duke shtuar një perspektivë të rëndësishme në debatin aktual mbi politikën tatimore. Rezultatet dhe konkluzionet e kësaj analize mund të shërbejnë si udhërrëfyes për formulimin e politikave tatimore të ardhshme, me synimin e promovimit të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme në Kosovë.

Disa rekomandime që mund të jap në kuadër të çështjeve që kam trajtuar në punimin e diplomës janë:

- Qeveria duhet të monitoroj efektet e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të kryejë vlerësim periodik të ndikimit të tij në rritjen ekonomike. Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e politikave tatimore.
- Qeveria duhet të ofrojë stimuj fiskalë për ndërmarrjet vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë zbritje tatimore për investimet dhe krijojë kushte të favorshme për rritjen e sektorit të korporatave.
- Përmirësimi i sistemit së tatimit mbi të ardhurat personale duhet të përfshijë ndryshime që inkurajojnë kontributin tatimor dhe ulin evazionin. Kjo do të ndihmonte në rritjen e burimeve për zhvillim ekonomik.
- Qeveria mund të zhvillojë një strategji tatimore që lehtëson barrën mbi pronarët dhe qiradhënësit për të nxitur rritjen e tregut të pasurive të ndërtimit dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike të Kosovës, poashtu rishikimi apo rifreskimi i tatimit mbi qiranë, dhe organizimin e një kampanje vetëdijësuese mbi kryerjen e detyrimeve tatimore nga secila kategori.

Referenca

- Administrata Tatimore e Kosovës (2023). Te Hyrat. 2018 – 2022. Ëebfaqja Zyrtare <https://www.atk-ks.org/open-data/>
- Amughoru Onome Austin, (2019). EFFECT OF TAXATION ON ECONOMIC GROWTH IN NIGERIA: A TIME SERIES ANALYSIS BETWEEN 1981-2019.
<https://journals.unizik.edu.ng/index.php/jocia/article/view/895>
- Banka Botërore – Webfaqja Zyrtare <https://www.worldbank.org/en/home>
- Bird, Richard (1996). Paper Analysis Ëhy Tax Corporations? WORKING PAPER 96-2. Pp.5 – 16.
<https://citeseerx.ist.psu.edu/document?repid=rep1&type=pdf&doi=0242274e359f39805844bf32d6dab0efe719748f>
- Devereux, Griffith, (1998) Paper Analysis Taxes and the location of production: evidence from a panel of US multinationals, Journal of Public Economics, 1998, vol. 68, issue 3, 335-367
<https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0047272798000140>
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 24 / 18 gusht 2015, PRISHTINË 1
LIGJI Nr. 05/L -029 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11016>
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJI NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË
TË ARDHURAT PERSONALE <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11014>
- Hungerford Th, Thiess R.(2013), THE EARNED INCOME TAX CREDIT AND THE CHILD TAX CREDIT History, Purpose, Goals, and Effectiveness pp.12 – 16 . <https://files.epi.org/2013/The-Earned-Income-Tax-Credit.pdf>
- Johnson, S., Kaufmann, D. and Zoido-Lobaton, P. (1998) Regulatory Discretion and the Unofficial Economy. The American Economic Review, 88, 387-392.

[https://www.scirp.org/\(S\(lz5mqp453edsnp55rrgjet55.\)\)/reference/referencespapers.aspx?referenceid=2547689](https://www.scirp.org/(S(lz5mqp453edsnp55rrgjet55.))/reference/referencespapers.aspx?referenceid=2547689)

Komoni, S (2011), Financat Monetare, Prishtinë. <https://pdfexist.com/download/3049782/Financat%20Monetare%20Sabaudin%20Komoni.pdf>

Komoni, S. (2008). Financat Publike, Prishtinë, Fakulteti ekonomik 2008.

Laws of Kenya (2012) KENYA REVENUE AUTHORITY ACT,
http://kenyalaw.org/kl/fileadmin/pdfdownloads/Acts/KenyaRevenueAuthorityAct_Cap469.pdf

Metcalf, E. G., 1995. Value-Added Taxation: A Tax Whose Time Has Come?. *Jstor*, 9(1), pp. 121-140. <https://pubs.aeaweb.org/doi/pdfplus/10.1257/jep.9.1.121>

Mikesell, J., 2011. Fiscal Administration Analysis and Applications for the Public Sector. 8th re 396 - 428. <https://handoutset.com/wp-content/uploads/2022/06/Fiscal-administration-analysis-and-applications-for-the-public-sector-John-L-Mikesell.pdf>

Mintz Jack, (1996), Corporation Tax: A Survey, *Fiscal Studies*, vol. 16, no. 4, pp. 23-68.
<https://citeseerx.ist.psu.edu/document?repid=rep1&type=pdf&doi=8b5e4174ff81819787f5d4a32bc92b0c78dc56ac>

Ormaechea, A dhe Morozumi, S.A. (2021). The value-added tax and growth: design matters. *Int Tax Public Finance* 28, 1211–1241. <https://doi.org/10.1007/s10797-021-09681-2>

Paulus, A., and A. Peichl, 2008. "Effects of Flat Tax Reforms in Western Europe on Income Distribution and Work Incentives," The Institute for the Study of Labor (IZA) Discussion Paper, No. 3721. 620-636 <https://www.iza.org/publications/dp/3721/effects-of-flat-tax-reforms-in-western-europe-on-income-distribution-and-work-incentives>

Peter K, Vasquez J, Gorodnichenko Y,(2008). MYTH AND REALITY OF FLAT TAX REFORM: MICRO ESTIMATES OF TAX EVASION RESPONSE AND WELFARE EFFECTS IN RUSSIA. pp. 17 – 53 . https://www.nber.org/system/files/working_papers/w13719/w13719.pdf

Rregullore Nr.2001/11, UNMIK (2001), PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR.

https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_11.htm

Seligman, A (1908), American Economic Association Quarterly, Dec., 1908, 3rd Series, Vol. 9, No. 4 pp. 1-334.

https://www.jstor.org/stable/pdf/3000009.pdf?refreqid=excelsior%3Af3f9c5a6a20da38af5067bd2dc7e87d1&ab_segments=&origin=&initiator=&acceptTC=1

Serem W, Robert K, Philip O (2017), THE EFFECT OF TAX SYSTEM SIMPLICITY ON TAX COMPLIANCE AMONG THE RENTAL INCOME EARNERS IN KENYA. A CASE OF ELDORET CENTRAL BUSINESS DISTRICT. European Journal of Business and Innovation Research Vol.5, No.5, pp.13-22. <file:///C:/Users/Admin/Desktop/Material/serem-%20business%20school%20referenca.pdf>

Tosun M, Abizadeh S, (2005), Economic growth and tax components: an analysis of tax changes in OECD. Applied Economics, 37, 2251–2263. [https://www.researchgate.net/profile/Mehmet-Tosun-](https://www.researchgate.net/profile/Mehmet-Tosun-4/publication/24075588_Economic_growth_and_tax_components_An_analysis_of_tax_changes_in_OECD/links/02e7e51ca7dfc153dd000000/Economic-growth-and-tax-components-An-analysis-of-tax-changes-in-OECD.pdf)

[4/publication/24075588_Economic_growth_and_tax_components_An_analysis_of_tax_changes_in_OECD/links/02e7e51ca7dfc153dd000000/Economic-growth-and-tax-components-An-analysis-of-tax-changes-in-OECD.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Mehmet-Tosun-4/publication/24075588_Economic_growth_and_tax_components_An_analysis_of_tax_changes_in_OECD/links/02e7e51ca7dfc153dd000000/Economic-growth-and-tax-components-An-analysis-of-tax-changes-in-OECD.pdf)

UDHËZIMI ADMINISTRATIV MF- Nr. 03/ (2015) PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-037 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR. Republika e Kosovës , Qeveria ,Ministria e Financave. <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/07/UA-03-2015.pdf>